

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "IPM Group" Sh.p.k.

Sot, me datë 06.04.2021.

Z. Izmir Reshketa, shtetas Shqiptar, lindur më 06/04/1992, ne Shkoder, Shqiperi, mbajtës i kartese se Identitetit me nr.034535514, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**IPM Group**"(më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**IPM Group**" Sh.p.k.

NENI 2


SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane ,Kashar ,MEZEZ, Autostrada Tirane-Durres km 0, ishSerrat,Rruga 'Pavaresia' Mezez., ZK2679, Kompleksi 'Shkodra Beton', Seksioni 1.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3

KOHËZGJATJA



Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *Tregti te gomave, te te gjitha llojeve, per te gjitha llojet e automjeteve, baterive, pjese kembimi dhe aksesore te tyre. Import- export te gomave .Servis dhe sherbime te ndryshme per te gjitha llojet e automjeteve, etj.*

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 1.000.000 leke dhe është i ndarë në 1 kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Izmir Reshketa**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 Leke dhe 1.000.000 Leke të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANETE SHOQËRISË

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Arrosh Halil".

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm i shoqërisë është **Z.Izmir Reshketa**, shtetas Shqiptar, lindur më 06/04/1992, në Shkoder, Shqiperi, mbajtës i Kartes se Identitetit me nr.034535514 , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Akitit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar _____ shtetas Shqiptar, lindur më _____, në _____, Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr._____, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Izmir Reshketa

